

<b>DHOMA E POSAÇME E GJYKATËS SUPREME TË KOSOVËS PËR ÇËSHTJE QË LIDHEN ME AGJENCINË KOSOVARE TË MIRËBESIMIT</b>	<b>SPECIAL CHAMBER OF THE SUPREME COURT OF KOSOVO ON KOSOVO TRUST AGENCY RELATED MATTERS</b>	<b>POSEBNA KOMORA VRHOVNOG SUDA KOSOVA ZA PITANJA KOJA SE ODNOSE NA KOSOVSKU POVERENIČKU AGENCIJU</b>
---	--	---

**ASC -09-0102**

Në padinë e

*Paditës/Ankues*

1. [REDACTED]
2. [REDACTED], të dy nga Gjakova, [REDACTED]  
të përfaqësuar nga [REDACTED], Avokat, [REDACTED], Gjakovë

kundër

*E Paditura*

[REDACTED]-Gjakovë

Kolegji i Ankesave i Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit (DHPGJS), i përbërë nga Richard Winkelhofer, Kryetar i DHPGJS-së, si Gjyqtar Kryesues, Torsten Frank Koschinka dhe Eija-Liisa Helin, Gjyqtarë, duke vendosur sipas ankesës së Paditësit kundër vendimit të DHPGJS-së, SCA-07-0055 të datës 24 nëntor 2009, lidhur me suspendimin e procedurës për shkak të procedurës së falimentimit të se Paditurës, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur me 4 shkurt 2010 lëshon këtë:

### **AKTVENDIM**

Refuzohet ankesa si e pabazuar. Vërtetohet vendimi i DHPGJS-së i datës 24 nëntor 2009, SCA-07-0055.

**Arsyet Ligjore:**

Në padinë e tyre të datës 14 dhjetor 2005 ushtruar në Dhomën e Posaçme, Paditësit kërkonin nga e Paditura që t'ua njohin atyre të drejtën si pronarë legjitim të disa parcelave kadastrale, ta bëjë dorëzimin e këtyre ngastrave dhe që t'ua lejojë regjistrimin e së drejtës së tyre në pronësi në regjistrat kadastral.

Me 15 shkurt 2006, Dhoma e Posaçme ia ka dorëzuar lëndën SCC-05-0552 Gjykatës Komunale në Gjakovë, si gjykatë kompetente në vendosjen e ankesave kundër vendimeve të tyre.

Me aktgjykimin C. nr. 128/96 të datës 23 mars 2007, Gjykata Komunale në Gjakovë e ka refuzuar padinë mbi bazën se të gjitha asetet e së paditurës kanë kaluar në [REDAKTUAR]. Andaj e paditura nuk ka legjitimitet pasiv (shih fq. 36 të dosjes së shkallës së parë)

Në ankesën e tyre dorëzuar Trupit Gjykses të DHPGJS-së, me datë 17 gusht 2007, kundër këtij vendimi Paditësit kishin qëllim ndryshimin e saj që ta "obligojnë përfaqësuesin ligjor të së paditurës AKM ... që ta anulojë kontratën e shitblerjes ... dhe ta ndërpres procedurën e likuidimit të [REDAKTUAR] [REDAKTUAR] .." (shih fq. 13 të dosjes së shkallës së parë).

Dhoma e posaçme e pezulloi përkohësisht procedurën, për shkak të pezullimit të funksionimit të AKM-së, sipas UE-së së UNMIK-ut 2008/34 (shih fq. 74 të dosjes së shkallës së parë)

Me 11 qershor 2007, Dhoma ne Posaçme tashmë ishte njoftuar nga AKM-ja se likuidimi i së paditurës kishte filluar me 14 maj 2007, në mënyrë spontane duke kërkuar nga Dhoma e Posaçme që ti pezullojë të gjitha lëndët kundër së paditurës.

Me vendimin e atakuar, Dhoma e posaçme e ka hequr pezullimin (1) dhe e ka pezulluar procedurën në saje të procedurës vazhduese të likuidimit të së paditurës (2) në arsyetimin ligjor duke iu referuar : Seksionit 212, nenit 4

dhe 6 të Ligjit të Procedurës Kontestimore” dhe Seksionit 9.3 të Rreg. së UNMIK-ut 2002/12 si të ndryshuar me Rreg. së UNMIK-ut 2005/18, dhe duke i informuar Paditësit se mund ta ushtrojnë padinë e tyre “në komitetin për likuidime të emëruar për Ndërmarrje nga Agjencia Kosovare e Mirëbesimit”.

Në ankesën e datës 7 dhjetor 2009, Paditësit kërkojnë ndryshimin e vendimit të atakuar për të vazhduar me procedurën “kundër të Paditurës, komisionit për likuidim të emëruar nga AKM...”

Ankesa duhet të refuzohet si e pabazuar.

Siç citohet nga Trupi Gjykses, Seksioni 9.3 i Rreg. së UNMIK-ut , e ndryshuar me Rregulloren e UNMIK-ut 2005/18, thotë si vijon:

“9.3 Çdo procedurë ligjore kundër ndonjë Ndërmarrje në pronësi shoqërore, që i nënshtrohet likuidimit sipas këtij seksioni do të pezullohet me kërkesë të Agjencisë drejtuar gjykatës së vendit ku padia është ushtruar, kërkesa e tillë duhet të shoqërohet me:

- a) Dëshminë e dorëzimit së njoftimit të përshkruar në nenin 39.3 të Rregullores mbi Organizimin e Bizneseve ( ku lëndë e procedurës së likuidimit është Korporata);
- (b) Dëshminë e publikimit të informacionit që përmban ai njoftim në botimet më të mëdha në gjuhën Shqipe të qarkullimit masiv në Kosovë një herë në javë apo 2 javë me radhë, dhe në botimet më të mëdha në gjuhën Serbe sipas kriterëve të përcaktuara nga Bordi;
- (c) Dëshminë e shfaqjes së saj në web-sajtin të Agjencisë në Shqip, Serbisht dhe Anglisht nëse ekziston web-sajti në kohën e likuidimit; dhe
- (d) Dëshminë e njoftimit të subjekteve, të cilat Agjencia beson ose duhej logjikisht të besonte, se ekziston një padi kundër Ndërmarrjes Shoqërore përkatëse.”

Pastaj, Neni 13.1 UA-së së UNMIK-ut 2007/1 në zbatim të Rreg. së UNMIK-ut 2005/48 mbi Riorganizimin dhe Likuidimin e Ndërmarrjeve dhe asketeve të tyre nën kompetencën administrative të Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit, thotë se njoftimi i shoqëruar me dëshmi të kërkuara e ka efektin e moratoriumit siç paraqitet në Seksionin 5.1 të Rreg. së UNMIK-ut 2005/48.

Njoftimi i AKM-së i datës 11 qershor 2007 drejtuar Dhomës së Posaçme rreth fillimit të procedurës së likuidimit të së paditurës i plotëson kriteret e paraqitura në dispozitën e përshkruar. Në veçanti, lista e paditësve të cilët qenë njoftuar drejtpërdrejtë nga AKM-ja i përfshinë edhe Ankuesit.

Në këto rrethana pezullimi i lëndës, siç udhëzohet nga Trupi Gjykses, ishte rrjedhojë e detyrueshme. Vazhdimi i procedurës "kundër Komisionit të Likuidimit të së paditurës i emëruar nga AKM..", siç ka kërkuar paditësi, para Dhomës së Posaçme nuk është i mundur dhe ishte në kundërshtim me parimet e barazisë së të gjithë kreditorëve në procedurën e likuidimit. Vetëm pohimet e kërkesave të kreditorëve para Komisionit për Likuidim e sigurojnë këtë tretman të barabartë.

Çdo pakujdesi nga ana e Gjykatës Komunale të Gjakovës në dorëzimin e aktgjykimit të tyre, siç kërkohet nga Ankuesit, nuk mund të pranohet nga Dhoma e Posaçme. Pos kësaj, nuk mund të kuptohet pse ata nuk do të ishin në gjendje ti drejtohen Komisionit të Likuidimit, pas hapjes së procedurës së likuidimit e cila shpallet dhe u njoftohet drejtpërdrejt atyre, edhe pse vendimi i shkallës së parë është dashur të epej menjëherë pas njoftimit.

Vendimi mbi shpenzimet nuk duhej të merrej.

Richard Winkelhorf, Gjyqtar Kryesues, EULEX (nënshkrimi)

Torsten Koschinka, Gjyqtar, EULEX (nënshkrimi)

Elija-Liisa Helin, Gjyqtare, EULEX (nënshkrimi)

Tobias Lapke, Regjistruer, EULEX (nënshkrimi)